

## Syllabusi i lëndës

**Lënda:** Institucioni i Vakëfit

**Programi i studimit:** Studime Islame

**Numri i ECTS kredive:** 5

**Statusi i lëndës:** Obligative

**Kodi i lëndës:** 405

**Fondi i orëve:** 2+1

**Viti akademik:** 2026/2027

**Semestri:** VII

**Mësimdhënësi:** Prof. Asoc. Dr. Islam Hasani

### **Përmbajtja e shkurtër e lëndës:**

Vështrim institucionit të vakëfit përgjatë historisë së tij e deri në periudhën bashkëkohore, duke u fokusuar me theks të veçantë në praninë e vakëfit në trojet tona. Prezantohen format, llojet dhe karakteristikat e vakëfit sipas të drejtës islame dhe paraqitjes së tij ndër shekuj.

Të njihen qëllimet dhe kushtet kryesore të vakëfit, pastaj roli i tij në zhvillimin e kulturës dhe qytetërimit islam tek myslimanët në përgjithësi, dhe tek shqiptarët dhe hapësirat tona, në veçanti.

Të njihen institucionet vakëfnore në trojet tona dhe vakëflënësit më të njohur, vakëfet e të cilëve ekzistojnë edhe sot.

Të njihen monumentet reprezentative të lëna vakëf dhe ndërtuesit e tyre.

Institucioni i vakëfit dhe trashëgimia vakëfnore të shpjegohet dhe të trajtohet si pjesë e pandashme e trashëgimisë sonë kombëtare dhe botërore.

### **Qëllimi i lëndës:**

Qëllimi i kësaj lënde është që të hulumtohen fillet, zhvillimet, llojet, karakteristikat dhe veçoritë kryesore të vakëfit ndër shekuj. Theks i veçantë i kushtohet sidomos institucionit të vakëfit në trojet shqiptare. Të njihemi me të drejtën vakëfnore në kuadër të së drejtës së përgjithshme islame, me një fjalë vendi i të drejtës vakëfnore në Sheriatin islam. Të njihen llojet kryesore të vakëfeve, pastaj institucionet kryesore të lëna vakëf. Të njihet roli i valëfit në përhapjen e fesë islame në botë. Pastaj të njihemi me rolin dhe kontributin e vakëfit në zhvillimin e kulturës dhe trashëgimisë sonë islame. Roli i vakëfit në arsimimin dhe shkollimin e popullatës tonë përgjatë historisë (mejetepet, medresetë bibliotekat, teqetë etj.)

Të njihet roli i vakëfit në zhvillimin ekonomik, urbanistik dhe social të vendbanimeve tona (urbanizimi i qyteteve shqiptare, hanet, karvansarajet, imaretet etj).

Të njihen monumentet reprezentative të lëna vakëf dhe ndërtuesit e tyre. Të njihemi me sfidat dhe perspektiven e vakëfit sot. Synohet të ngritën debate dhe të zhvillohen diskutime, të paraqiten pikëpamje e botëkuptime që do të nxisin dhe do të provokojnë mendimin kritik tek studentët.

Me theks të veçantë synohet që me fakte dhe argumente objektive, reale e shkencore dhe përmes debateve dhe mendimit kritik, të paraqitet dhe të dëshmohet ndikimi dhe vendi i vakëfit në kuadër të së drejtës së Sheriatit në kuadër të trashëgimisë sonë shqiptare islame. Institucioni i vakëfit për shkak të shtrirjes së tij kohore dhe hapësinore, për shkak të karakteristikave dhe veçorive të tij, për shkak të rolit në përhapjen dhe zhvillimin e fesë islame të të kulturës së saj dhe për shkak të vakëflënësve dhe bamirësve të mëdhenj që kanë lënë vakëfe të llojllojshme dhe të panumërta, konsiderohet si pjesë e pandashme e trashëgimisë sonë shqiptare dhe botërore. Vakëfi shpjegohet dhe trajtohet si pjesë e pandashme e trashëgimisë sonë kombëtare dhe botërore.

### **Rezultatet e pritura të nxënies:**

Pas përfundimit të këtij cikli të ligjëratave studenti do të jetë në gjendje që:

- Të shpjegoj fillet, zhvillimet, llojet, karakteristikat dhe veçoritë kryesore të vakëfit ndër shekuj.
- Të njoh vendin e së drejtës vakëfnore në kuadër të së drejtës së përgjithshme të Sheriatit.
- Të njoh sidomos institucionin e vakëfit në trojet shqiptare dhe disa nga vakëflënësit më të njohur shqiptarë në botë dhe ndër ne.
- Të njoh rolin e vakëfit në përhapjen e fesë islame dhe të kulturës së saj në botë dhe ndër ne.
- Të paraqes në mënyrë objektive dhe të paanshme vlerat e institucionit të vakëfit.
- Të diskutoj për vendin që vakëfi zënë në kuadër të trashëgimisë sonë kombëtare dhe botërore.
- Të argumentoj nevojën për njohjen e vakëfit në përgjithësi dhe të vakëfit ndër shqiptarët në veçanti.

### **Metodologjia e mësimdhënies:**

- Mësimdhënia do të zhvillohet në formën e ligjëratave.
- Në nxitjen dhe provokimin e debateve ndër studentët.
- Me përfshirjen e studentëve në diskutime.
- Përmes punimeve të seminareve dhe kolekfiumeve.

### **Përmbajtja e lëndës:**

**Java e parë:** Paraqitje e përgjithshme për lëndën. Njohja me pasqyrën e lëndës; kuptimi dhe lënda e studimit, si dhe metodat e studimit të lëndës së Institucioni i Vakefit. Hyrje në historinë e së drejtës vakëfnore (përkufizimet për vakëfin)

**Literatura:** John L. Esposito (editor in Chief), *The Oxford Dictionary Of Islam*, Oxford University Press, Inc, 2003. Kjo vepër është përkthyer edhe në gjuhën shqipe nga Mimoza Sinani dhe është botuar nga “Logos-A”, Shkup, 2017. 2010.

**Java e dytë:** Fillet, historiku dhe zhvillimet e vakëfit përgjatë historisë islame.

**Literatura:** Selim Argun, *Elite Configurations and Clusters of Power: The Ulema, Waqf, and Ottoman State (1789-1839)* (Ankara: Gravity International Print and Design, 2013)

**Java e tretë:** Llojet, karakteristikat, veçoritë dhe dokumentet kryesore të vakëfit (huxhxheti dhe vakëfnameja).

**Literatura:** Osman Nuri Topbash, *Vakëfi, dhurimi dhe shërbimi*, përktheu Mithat Hoxha, pa vend dhe vit botimi.

**Java e katërt:** Roli i vakëfit në përhapjen e fesë islame.

**Literatura:** Hasan Kaleshi, *Dokumentet më të vjetra vakëfnore në gjuhën arabe në ish-Jugosllavi*, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2010.

**Java e pestë:** Roli i vakëfit në përhapjen e fesë islame dhe institucioneve të saj tek shqiptarët.

**Literatura:** Hasan Kaleshi, *Dokumentet më të vjetra vakëfnore në gjuhën arabe në ish-Jugosllavi*, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2010.

**Java e gjashtë:** Roli i vakëfit në zhvillimin ekonomik dhe social

**Literatura:** Selim Argun, *Elite Configurations and Clusters of Power: The Ulema, Waqf, and Ottoman State (1789-1839)* (Ankara: Gravity International Print and Design, 2013)

**Java e shtatë:** Roli i vakëfit në zhvillimin urbanistik të qyteteve tona.

**Literatura:** Hasan Kaleshi, *Dokumentet më të vjetra vakëfnore në gjuhën arabe në ish-Jugosllavi*, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2010.

**Java e tetë:** Roli i vakëfit në përhapjen e kulturës dhe arsimimit islam ndër ne.

**Literatura:** Sadik Mehmeti, Roli i vakëfit në përhapjen e kulturës dhe arsimimit islam në vendin tonë, Takvim/Kalendar, 2009, Prishtinë, f. 125-147.

**Java e nëntë:** Monumentet sakrale të lëna vakëf në trojet tona (imaretet (kuzhinat popullore, hanet, karvansarajet, çezmat, kullat e sahatit etj.), roli dhe rëndësia e njohjes së tyre, historiku, themeluesit dhe gjendja e tyre sot.

**Literatura:** “Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017;

**Java e dhjetë:** Monumentet profane islame të lëna vakëf në trojet tona; roli dhe rëndësia e njohjes së tyre, historiku, themeluesit dhe gjendja e tyre sot.

**Literatura:** Sadik Mehmeti, Shkollat dhe arsimi në Kosovë (1830-1912), Prishtinë, 2019.

**Java e njëmbëdhjetë:** Xhamitë monumentale të kulturës islame në Kosovë, Iljaz Rexha. Monumentete e kulturës islame në Kosovë, “Edukata Islame”, nr. 75, Prishtinë, 2004; Dr. Fejaz Drançolli, *Xhamia e Hadumit në Gjakovë*,

**Literatura:** “Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017;

**Java e dymbëdhjetë:** Mejtepet, medresetë dhe bibliotekat në Kosovë përgjatë shekujve, historiku, roli dhe themeluesit e tyre.

**Literatura:** Sadik Mehmeti, Shkollat dhe arsimi në Kosovë (1830-1912), Prishtinë, 2019.

**Java e trembëdhjetë:** Vakëflënës të shquar shqiptarë dhe vakëfet e tyre nëpër botë.

**Literatura:** “Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017;

**Java e katërbëdhjetë:** Vakëflënës të shquar shqiptarë dhe vakëfet e tyre në trojet tona.

**Literatura:** “Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017;

**Java e pesëmbëdhjetë:** përmbledhje e lendes

### **Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:**

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

### **Literatura obliguese:**

1. Dr. Hasan Kaleshi, Dokumentet më të vjetra vakëfnore në gjuhën arabe në ish-Jugosllavi, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2010.

2. Osman Nuri Topbash, Vakëfi dhe zeqati, Stamboll, 2008.

### **Literartura shtesë:**

1. *“Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare”*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017.

2. Sadik Mehmeti, Shkollat dhe arismi në Kosovë (1830-1912), Prishtinë, 2019.

3. Iljaz Rexha, *Monumente të kulturës islame të shek XV – XVI në Kosovë*, “Edukata Islame”, nr. 75, Prishtinë, 2004.

4. Selim Argun, *Elite Configurations and Clusters of Power: The Ulema, Waqf, and Ottoman State (1789-1839)* (Ankara: Gravity International Print and Design, 2013)